

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(MMPH),Komuna e Prizrenit dhe EkoRegjioni kanë inicuar **Projektin për Ngritjen e Kapaciteteve në Menagjimin e Mbeturinave drejtë një Shoqërie të Shëndoshë ("Projekti")** në bashkëpunim me Agjensionin Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) në Komunën e Prizrenit që në Gusht 2011.Projekti do të implementohet deri në Gusht 2014. Ky është buletini jonë i parë dhe me këtë paraqesim sfondin e projektit si dhe aktivitetet.



**Qyteti i Prizrenit**

**Sfondi:** Republika e Kosovës ka kërkuar nga Qeveria Japoneze asistencë teknike në fushën mjedisore.Në përgjigje të kësaj,JICA ka kryer studimin e Menagjimit Mjedisor' (Mars 2010) dhe 'Studimin e Menagjimit të Mbeturinave të Ngurta' (Korrik 2011).Përmes rezultateve të këtyre studimeve,JICA ka gjetur se Menagjimi I Mbeturinave të Ngurta është njëra nga çështjet më kritike në Kosovë. Shkalla e grumbullimit të Mbeturinave ka qenë tejte e ulët dhe shërbimi I grumbullimit nuk ka qenë I mjaftueshëm.Kushtet sanitare kanë nevojë për përmirsim.Në Prizren shkalla e grumbullimit ishte vetëm 60 përqind.Pasiqë popullsia është rritur ndjeshëm që nga viti 2003 (nga 120,000 në 177,260 sipas regjistrimit të fundit të popullsisë/2011) urgjentisht është i nevojshëm përmirsimi i sistemit të grumbullimit.

Qeveria e Kosovës ka formuluar strategji për Menagjimin e Mbeturinave për periudhën 10 vjeqare (2010-2020) si politika zhvillimore për Menagjimin e Mbeturinave të Ngurta.Strategjia përmend arritjet e pakësimit të ndotjes mjedisore të shkaktuar nga mbeturinat,përmirsimin e shërbimit të grumbullimit në tërë vendin, realizimin e një cikli material të shëndoshë përmes 3R (ripërdorimit dhe reciklimit të Mbeturinave).Në përputhje me strategjitë,Kosova ka kërkuar një projekt të grantit ndihmës si dhe projektin e bashkëpunimit teknik " **Projektin për Ngritjen e Kapaciteteve në Menagjimin e Mbeturinave drejtë një Shoqërie të Shëndoshë** " nga Qeveria e Japonisë.Pas kësaj,JICA ka studiuar atë që duhet të bëhet në Projekt (Komponentët e Projektit),si dhe relevancën e implementimit të Projektit në Dhjetor 2010.Përmbajtja e Projektit ka marrë pajtimin e MMPH dhe është nënshkruar Procesverbal i Diskutimeve (P/D) me 26 Janar 2011. Pastaj nënshkrimi I Projektit është bërë në Gusht.



**Pamje nga P/D në Prishtinë me 26 Janar 2011,menjëherë pas ceremonies së nënshkrimit**  
(<http://www.jica.go.jp/balkan/office/informati on/event/110208.html>)

**Sfidat:** Siç u përmend në sfond, 'rritja e shkallës së grumbullimit të mbeturinave' dhe 'realizimi i një shoqërie të ciklit material përmes 3R (ripërdorimi dhe reciklimi I Mbeturinave)'janë sfidat e gjendjes në Prizren.





## 2) Ekipi I Ekspertëve të JICA-s

JICA ka dërguar ekspertët nga Kokusai Kogyo Co., Ltd nga Japonia. Pozitat e tyre në Projekt dhe emrat tregohen si më poshtë.

- Kryekëshilltar/Menagjimi I Mbeturinave të Ngurta: Zt. Junji ANAI
- Zv/Kryekëshilltar/ Planifikimi I Grumbullimit dhe transportimit: Zt. Hiroshi FUJITA
- Analizimi I Përbërjes së Mbeturinave: Zt. Masayuki TAKAZAWA
- Planifikimi I menagjimit të deponisë: Zt. Hideo SATO
- Edukim Mjedisor/ Vlerësimi I Kapaciteteve: Znj. Chiaki NISHI
- Mirëmbajtja dhe Menagjimi I Pajisjeve: Mr. Koji UZAWA

## 3) Komiteti I Përbashkët Koordinues (KPK)

KPK është themeluar për të monitoruar/vlerësuar progresin e projektit.KPK përbëhet nga anëtarët si më poshtë.

- Kryesuesi:** Sekretari i Përgjithshëm I MMPH.
- Anëtarët e komitetit nga pala Kosovare**
  - Udhëheqësi, Divizioni për Kemikate dhe Mbeturina, MMPH
  - Udhëheqësi, Divizioni për Mbrojtjen e Mjedisit, MMPH
  - Drejtori, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komuna e Prizrenit
  - Koordinatori i Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike,Komuna e Prizrenit
  - Stafi Teknik,Drejtoria e Shërbimeve Publike,Komuna e Prizrenit
  - Përfaqësues nga vendi i pilot projektit në Komunën e Prizrenit
  - Zyrtar të lartë, Drejtorati për zhvillime Njerzore dhe Fizike, Ministria e Integritimeve Europiane ( MIE)
- Antarët e Komitetit nga Pala Japoneze**
  - Shefi Përfaqësues,Zyra e JICA-s për Ballkan
  - Ekipi I ekspertëve të JICA-s




Takimi I pare I KPK-së me 12 Shtator 2011

## II. Përshkrimi i Aktiviteteve

Progresi i Projektit të JICA-s për bashkëpunim Teknik do të monitorohet/vlerësohet nga misioni vlerësues i dërguar nga zyra qendrore e JICA-s në të ardhmen. Misioni vlerësues me kujdes do të shikoj se në çfarë mase është arritur qëllimi i Projektit.Qëllimi i projektit është arritur kur të arrihen rezultatet në një shkallë të kënaqshme.Çdo rezultat ka aktivitetet e veta.Rezultati arrihet atëherë kur ato aktivitete bëhen ashtu si duhet. Pa u bërë aktivitetet ashtu si duhet,qëllimi I Projektit nuk arrihet.Aktivitetet për secilin rezultat duhet të jenë sqaruar mire.

### Logjika e komponenteve të Projektit (Aktivitetet,rezultatet,Qëllimi I Projektit)



### Aktivitetet kryesore për të arritur Rezultatin 1

Për të mësuar gjendjen aktuale të MMN duhet të bëhen disa studime përmbajtësore.Çdo studim do të bëhet pasi të jetë diskutuar metoda e studimit në mes të partnerëve dhe ekspertëve.Në këtë mënyrë ndodh transferi teknik.

i) Studimi I Sasisë dhe Përbërjes së Mbeturinave (SSPM): do të bëhet për të studijuar shkallën e gjenerimit të Mbeturinave (kg/ditë/njësi për burim gjenerues).

ii) Studimi I Kohës dhe lëvizjes: Do të bëhet për të studijuar gjendjen aktuale të shkarkimit dhe grumbullimit dhe të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me to.

iii) Studimi I Opinionit Publik: Do të bëhet për të studijuar shkallën e vetëdijësimit drejtë menagjimit të Mbeturinave mes subjekteve të biznesit.

iv) Studimi I opinionit të biznesit të operatorëve: Do të bëhet për të studijuar shkallën e vetëdijësimit drejtë menagjimit të Mbeturinave mes subjekteve të biznesit.

v) Studimi I aktiviteteve të Reciklimit : Do të bëhet për të studijuar grumbullimin e gjërave të

reciklueshme,shkallën e tregut të biznesit të grumbullimit gjërave të reciklueshme etj.

vi) *Studimi I tregut të Kompostit*: Do të bëhet për të analizuar fizibilitetin e kompostimit të Mbeturinave organike.

vii) *Monitorimi I Deponisë (Kapaciteti/ Mjedisi)*: Do të bëhet për të studijuar kapacitetin e deponisë si dhe kualitetin e ujit në deponi dhe përreth.

### **Aktivitetet kryesore për të arritur Rezultatin 2**

i) Ekspertët do të përkrahin zhvillimin e planit për menagjimin e Mbeturinave të Ngurta (MMN) për Komunën e Prizrenit bazuar në rezultatet e studimit të përmendur përmbajtësor.Në kornizën e MMN,synon sasinë e grumbullimit të Mbeturinave dhe planin strategjik në çdo process të Mbeturinave të gjeneruara/shkarkuara,grumbullimin/bartjen,procesimin e ndërmjetëm dhe hüdhen finale në deponi.Ekspertët do të përkrahin komunën e Prizrenit për të ndërtuar një konsensus me organizatat tjera relevante për zhvillimin e kornizës së MMN.

Plani I MMN do të përfshijë masat për përmirsimin e gjendjes së dobët financiare dhe masat për fuqizimin e kapaciteteve në Komunë nga këndvështrimi organizativ,duke marrë parasysh ndryshimin e sistemit të tashëm të grumbullimit të Mbeturinave i cili varet nga EKoRegjioni,në sistemin e ri ku komuna në mënyrë subjektive menagjon mbeturinat komunale.

Në mënyrë që të formulohet lehtë plani i MMN,do të bëhen disa pilot projekte.Ata do të operohen për të ekzaminuar fizibilitetin e sistemit të grumbullimit të Mbeturinave të prezentuar përmes planit të MMN.

Më poshtë sqarohen planet e pilot projekteve.Janë katër opcione.Secili opcion duhet të operohet duke përdorur të dhënat e marra nga studimi përmbajtësor.

i) *Përmirsimi i sistemit ekzistues të grumbullimit*. Ky pilot projekt do të bëhet për të ekzaminuar numrin e rrugëtimeve për grumbullimin e Mbeturinave si dhe përmirsimin e saktësisë në grumbullimin e Mbeturinave.

ii) *Prezentimi i grumbullimit me këmbanë*: Do të bëhet për të ekzaminuar se si të ndalet derdhja e mbeturinave,erërat e rënda rreth pikave të grumbullimit dhe në cilën shkallë mund të zvoglohen pikat e grumbullimit.

iii) *Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit*: Do të bëhet për të ekzaminuar mënyrën e zgjerimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave:si të mbulohen ato zona ku nuk ka pasur grumbullim të mbeturinave.

iv) *Monitorimi I Deponisë*: Do të bëhet për të mësuar kapacitetin e mbetur të deponisë si dhe jetëgjatësinë e përdorimit. Pastaj, do të ekzaminohet ndikimi mjedisor përreth deponisë.

### **Aktivitetet kryesore për të arritur Rezultatin 3**

Projekti analizon rezultatin e operimit të pilot projektit në Rezultatin 2.Bazuar në ato analiza,ekzaminohet fizibiliteti i planit të MMN formuluar në rezultatin 2.Ekipi i ekspertëve të JICA-s do të përkrah partnerët në studimin e fizibilitetit.

Plani i MMN i finalizuar do ti jepet përfaqësuesve të qytetarëve ( asamblesë komunale) dhe komunave tjera përmes seminareve.

### **Aktivitetet kryesore për të arritur Rezultatin 4**

Do të kryhen disa programe trajnimi për vetëdijësimin e komunitetit.Synimi kryesor i programeve do të jenë banorët resident si dhe studentët nga shkollat fillore dhe të mesme brenda vendeve të pilot projekteve.Nëse është e nevojshme,do të synohen edhe shitësit me pakicë.

Materiali për trajnim do të zhvillohet për përdorim nga komunat tjera.Nëse gjykohet e nevojshme për tu harmonizuar me programet ekzistuese për Edukim mjedisor,programet e tilla mund të inkorporohen.Mosha,etniciteti dhe aspektet tjera sociale do të merren në konsideratë dhe do të përdoren fotografi dhe ilustrime.Të gjitha materialet do të përgatiten në të dy gjuhët Anglisht dhe Shqip.Do të përgatiten poashtu video materiale.Pamje nga pilot projektet do të shfaqen në video materiale.

### **KONTAKT PËR INFORMATA**

#### **Personat kontaktues:**

Zt.Junji ANAI-Kryekëshilltarë

Zt.Hiroshi FUJITA – Zv/Kryekëshilltar

\*kontakt në Anglisht

Zt. Nehat BOJAXHIU, Asistent i Projektit

Nr.i telefonit: 044 191 488

Email: nehatbojaxhiu@gmail.com

Znj. Mimoza KELE, Asistente e Projektit

*\*telefon/ email në gjuhën Shqipe ose Anglisht*

#### **Adresa e zyrës:**

Zyra e projektit për Ngritjen e Kapaciteteve për Menagjimin e Mbeturinave drejtë një Shoqërie të Shëndoshë

Dhoma Nr. 70, kati i 4<sup>të</sup> , Kuvendi Komunal

(ish. Bankosi)

Rruga Remzi Ademaj

20000, Prizren, Republika e Kosovës